

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Have Haliti, kryetare, Xhevdet Abazi dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.U. nga fsh. ..., Komuna e Suharekës, për shkak të veprave penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nën par. 3 të KPK-së, duke vendosur për ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. E.R., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore – DKR në Prizren, P.nr.24/15 datë 24.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, më datë 18.08.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me pranimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.U., por edhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prizren, P.nr.24/2015, të dt. 24.03.2017, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, ashtu që Gjykata e Apelit, këtë vepër penale, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, e cilëson si vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore – DKR në Prizren, me aktgjykimin P.nr.24/15 datë 24.03.2017, e ka shpallur fajtor të akuzuarin H.U., për shkak të veprave penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par. 1 nënpar.3 të KPK-së, dhe për këto vepra penale, pasi më parë i ka përcaktuar për veprën e parë penale dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, ndërsa për veprën e dytë penale dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, me aplikimin e dispozitave të nenit 80 të KPK-së, për shqiptimin e dënimeve për veprat penale në bashkim, e ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 (muaj) muaj, në të cilin dënim të akuzuarit i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 09.07.2008 e deri më dt. 15.07.2008.Të akuzuarin e ka obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të shumës së paushallit gjyqësor shumë prej 400 (katërqind) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarën “Agrokosova Holding” dhe Administratën Tatimore të Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit H.U. , av. E.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, ose të ndryshohet vendimi për dënim dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i butë me burgim ose çështje ta kthejë në rivendosje.

Gjykata e Apelit, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës së nenit 390 par. 1 të KPPK, për të cilën njoftoi Prokurorin e Apelit, të dëmtuarin, të akuzuarin dhe mbrojtësit e tij. Në seancën e kolegjit ishin të pranishëm i akuzuari H.U., av. Ethem Rugova, përfaqësuesit e palës së dëmtuar av. Hysni Ismajli dhe av. Shpresa Berisha-Rexhepi, ndërsa, edhe pse të ftuar në mënyrë të rregullt nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA.nr.285/17 datë 13.06.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje penalo-juridike, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjetjet e gjykatës

Në ankesën e paraqitur të mbrojtësit të akuzuarit H.U., përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se aktgjykimi i ankimuar, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara me dispozitat e nenit 384 par.1 nënpar.12 e lidhur me nenin 370 par.6 e 7 të KPK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, në arsyetim nuk janë paraqitur arsyerat lidhur me faktet vendimtare, kurse arsyerat që janë paraqitur janë plotësisht të paqarta dhe në masë të konsiderueshme kundërthënëse, pastaj ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave, pastaj aktgjykimit në fjalë i mungon vlerësimi i provave dhe fakteve kundërthënëse dhe atë sidomos përkitazi me vërtetimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit. Pastaj, në dispozitiv nuk janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, pra përshkrimi i dispozitivit në aktgjykimin e ankimuar nuk përmban veprimet konkrete inkriminuese të të akuzuarit e të cilat do të përbënin elementet e veprës penale për të cilin i akuzuari është shpallur fajtor. Sipas dispozitivit në fjalë rezulton se i akuzuari në cilësinë e personit të autorizuar zyrtar, ka përpiluar dhe nënshkruar dy kontrata, dhe atë për shitjen e mallit të njëjtë – pra, verës në sasi prej 1 milion litra, një me çmim 0,17 cent ndërsa tjetre 0,20 cent, që i është shitur Ndërmarrjes nga Novi Pazar 'NN, e duke i ikur kështu pagimit të tatimit në fitim Administratës Tatimore të Kosovës. Nga një përshkrim i tillë, pra, gjithëherë sipas pretendimeve ankimore, nuk rezulton të jetë e qartë se cilat janë veprimet konkrete inkriminuese të akuzuarit që përbëjnë figurën e veprës penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 e lidhur me par.1 të KPK-së dhe të veprës penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nën par. 3 të KPK-së. Po ashtu, më tutje, pretendohet se i akuzuari nuk i konteston faktet dhe rrethanat e përshkruara në dispozitiv përkitazi me kontratat në fjalë, ngase këtë e ka bërë për shkak të nevojave të

ndërmarrjes 'NN nga Novi Pazari, por jo që edhe fakturat e shitblerjes të përpilohen në bazë të kontratave dhe të njëjtat ti paraqiten Administratës Tatimore të Kosovës, sikur që ka bërë kontabiliteti i ndërmarrjes, për çka konsideron se nuk është përgjegjës për një gjë të tillë. Po ashtu, pretendohet se edhe sa i përket të ardhurave personale, kompetent ka qenë kontabiliteti i ndërmarrjes e jo i akuzuari për realizimin e pagesës në emër të tatimit për të ardhurat personale, pastaj se edhe përkundër vërejtjeve të Gjykatës së Apelit në këtë çështje penalo-juridike, nuk është bërë identifikimi i palës së dëmtuar, gjë që të gjitha të metat në fjalë përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat ndikojnë domosdoshmërisht në anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të cekura si më lartë nuk qëndrojnë, nga se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesë e as shkelje tjera të cilat kjo gjykatë i shqyrton edhe sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, konkret, nuk përmban kundërrënie me vetë veten, e as me arsyetimin e tij, ngase, gjykata e shkallës së parë në dispozitiv ka paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtor, pra, nga përmbajtja e dispozitivit pa dyshim që rezulton se kemi të bëjmë me vepër penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar. 3 të KPK-së.

Po ashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyesash i merr si të provuara ose të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitave të nenit 370 par.7 të KPPK. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundimet e veta, të cilat si të drejta e të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Kështu në rastin konkret gjykata e shkallës së parë përkitazi me fakte vendimtare, përveç mbrojtjes së të akuzuarit, i cili nuk i konteston faktet dhe rrethanat se në Ndërmarrjen "Agrokosova Holding" ka qenë person përgjegjës dhe se me këtë cilësi ka nënshkruar dy kontrata për shitblerjen e verës në sasi prej 1 milion litra, për Ndërmarrjen 'NN nga Novi Pazari, ku në njëren kontratë ka figuruar çmimi prej 0,17 cent, ndërsa në kontratën tjetër 0,20 cent, pastaj se i njëjti po ashtu ka qenë përgjegjës për pagesën e të ardhurave personale për punonjësit në ndërmarrjen "Agrokosova Holding", fakte këto rrethana, që gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar edhe nga dëshmitarët A.T.,L.B.,F.K. por edhe nga provat materiale të ekspertizës së ekspertit financiar Isa Krasniqi, për çka, pastaj, me të drejtë edhe ka konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, se i akuzuari H.U., ka kryer veprat penale si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet ankimore përkitazi me vërtetimit e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe gjetjet e gjykatës

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë, në esencë kontestohet vetëm mënyra e vlerësimit të provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet të cilat ajo i ka nxjerrë të bazë të provave të proceduara. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme, prandaj edhe përfundimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në prova. Kështu, sipas pretendimeve të mbrojtësit gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka konstatuar se i akuzuari H.U. ka qenë i obliguar që të bëjë pagesën e tatimeve për mallin e shitur si dhe tatimin për të ardhurat personale të punësuarve të Ndërmarrjes

“Agrokosova Holding”, ngase, pra sipas pretendimeve ankimore, për këtë ka qenë e obliguar administrata e ndërmarrjes-kontabilitetit, për çka gjykata e shkallës së parë ka bërë edhe shkelje të ligjit penal kur të akuzuarin e ka shpallur fajtorë për veprat penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nën par. 3 të KPK-së .

Gjykata e Apelit, konstaton, se edhe përkitazi me këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë pretendimet e cekura si me lartë, nga se me pa mëdyshje, pra edhe nga vetë mbrojtja e të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar fakte dhe rrethanat se i akuzuari H.U., ka qenë i punësuar në Ndërmarrjen “Agrokosova Holding”, në cilësinë e Drejtorit menaxhues dhe se i njëjti në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes në fjalë, ka bërë nënshkrimin e kontratës për shitjen e verës në sasi prej 1 milion litra, me Ndërmarrjen “NN” nga Novi Pazari, dhe se me këtë rast i njëjti i ka bërë dy kontrata për të njëjtën sasi të mallit, njërën me çmim prej 0.17 cent, ndërsa tjetrën prej 0.20 cent dhe me këtë rast Administratës Tatimore të Kosovës, për pagesën e tatimit i është ofruar kontrata me çmim prej 0.17 cent. Po ashtu, në mënyrë të pa kontestuar gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se të ardhurat personale për muajin dhjetor të vitit 2007, janar, shkurt, mars dhe prill të vitit 2008, që i janë paguar G.K. në shumë prej 25.000 €, nuk është bërë fare llogaritja e tatimit në pagë e që është dashur të jetë në shumë prej 4.692,50 €, në dëme, pra të buxhetit të Kosovës. Fakte dhe rrethana në fjalë gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetuar edhe nga dëshmitarët F.K.,A.T. dhe L.B. si dhe me provat materiale – ekspertizën financiare të ekspertit Isa Krasniqi.

Përkitazi me faktet kontestuese se a është dashur që Shërbimit Tatimor – Administratës Tatimore të Kosovës, faktet në fjalë t’ia paraqes i akuzuari apo Shërbimi i Kontabilitetit të Ndërmarrjes, sikur që pretendohet në ankesë, gjykata e shkallës së parë, përveç dëshmitarit të cekur më lartë, ka marrë për bazë edhe ekspertizën financiare të ekspertit Isak Krasniqi, nga e cila është vërtetuar se përkitazi me nënshkrimin e dy kontratave për mallin e njëjtë e me çmime të ndryshme kanë qenë në dijeni përveç të akuzuarit edhe dëshmitarët e cekur më lartë, dhe se në librat e kontabilitetit për mallin e shitur në fjalë ka figuruar çmimi për litër 0.17 cent e jo 0.20 cent sa edhe ka qenë çmimi real, që nënkupton se është bërë shmangia nga realizimi i vërtetë i fitimit të ndërmarrjes “Agrokosova Holding” me shitjen e mallit në fjalë, për çka me këtë është dëmtuar Buxheti i Kosovës në shumë prej 5.085,40 €. Po ashtu, me ekspertizën e ekspertit të njëjtë gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se në bazë të kontratës së punës me G.K., të angazhuar në cilësinë e drejtorit teknik, shuma e pagës mujore ka qenë 6.600 €, të cilit shuma e mjeteve financiare prej 1.600 €, i janë paguar përmes llogarive bankare e duke paguar edhe tatimin e të ardhurave personale, ndërsa shuma tjetër prej 5.000 €, të punësuarit në fjalë, për pesë muaj radhazi – pra, shuma prej 25.000 €, i është paguar përmes xhirlogarisë tjetër private të punësuarit G.K. në Itali, e që nuk është bërë pra, fare pagesa e tatimit për të ardhurat personale për shumën në fjalë, e që me këtë, sipas ekspertizës në fjalë, është dëmtuar Buxheti i Kosovës, në shumë prej 4.692,50 €. Po nga ekspertiza në fjalë, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se që të dy pagesat në fjalë, pra, edhe në rastin e parë dhe të dytë janë bërë në bazë të autorizimit që e ka bërë i akuzuari H.U., në cilësinë e drejtorit të Ndërmarrjes “Agrokosova Holding”, që do të thotë se organet kompetente të Ndërmarrjes “Agrokosova Holding”, pagesën e tatimit ndaj buxhetit të Kosovës, e kanë bërë në bazë të urdhërësës së Drejtorit Menaxhues, pra të akuzuarit H.U.. Faktet dhe rrethanat në fjalë i ka vërtetuar edhe përmes provave tjera materiale, si dy kontratat në shkresat e lëndës, transfero e parave të bëra me autorizimin e të akuzuarit H.U., për drejtorin teknik G.K. në Itali, dhe Ndërmarrjen “NN” nga Novi Pazari.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat dhe arsyerat më detajisht të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, rezulton se konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari H.U., ka kryer veprat penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nën par. 3 të KPK-së, është i drejtë dhe se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat përbëjnë tiparet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Pretendimet ankimore përkitazi me shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit dhe gjetjet e gjykatës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore në drejtim të shkeljes së ligjit penal, në dëm të akuzuarit, pjesërisht janë të bazuara, ngase, në rastin konkret është shkëlur ligji penal kur gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor për vepër penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, ngase, gjykata e shkallës së parë, faktet vendimtare përkitazi me gjendjen faktike i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por me zbatimin e drejtë të Ligjit është dashur të merret aktgjykim me cilësim tjetër juridik të veprës penale, shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par. 3 e lidhur me par.1 të KPK-së, për çka edhe u vendos që aktgjykimi i shkallës së parë, të ndryshohet ashtu që veprimet inkriminuese të akuzuarit të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar, t'i cilësojë si vepër penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së. Në bazë të dispozitave të nenit 3 par. 2 të KPRK-së, ndaj kryesit të veprës penale zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa, në bazë të par. 2 të nenit 3, parashihet shprehimisht se nëse ligji në fuqi ndryshohet para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm, gjë që në rastin konkret duke pasur parasysh se ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është më i ashpër, ngase, për veprën penale në fjalë, parashihet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 deri në 8 vjet, ndërsa, me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, që është tani në fuqi, për veprën penale në fjalë parashihet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj e deri në 5 (pesë) vjet, atëherë qëndrojnë pretendimet ankimore në drejtim të kualifikimit juridik të veprës penale, ngase, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale parasheh dënim më të ashpër se sa ligji që është tani në fuqi, për çka aktgjykimi i shkallës së parë, u ndryshuar vetëm në kuptim të cilësimit juridik të veprës penale, pra, veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për sanksionin penal.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk janë të bazuara.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, përkitazi me këtë bazë ankimore pretendohet se edhe nëse konsiderohet se i akuzuari ka kryer veprat penale atëherë edhe ashtu vendimi për dënim është i ashpër, sidomos kur merren parasysh rrethanat lehtësuese, si moshja e të akuzuarit, gjendja e tij familjare, se është i martuar, se është i kualifikuar në nivelin më të lartë shkollor, pastaj, koha e kaluar nga kryerja e veprës penale e deri më sot, janë të gjitha këto rrethana lehtësuese që ndikojnë në zbutjen e mëtutjeshme të vendimit për dënim.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në ankesën e paraqitur nga mbrojtja nuk janë theksuar rrethana tjera lehtësuese të cilat kishin me pasur ndikim të drejtë për drejtë në lartësinë e dënimit, por faktikisht vetëm janë përsëritur rrethanat të cilat

edhe ashtu i ka pasur parasysh edhe gjykata e shkallës së parë, për çka kjo gjykatë vlerëson se në mënyrë të drejtë dhe të plotë janë konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, sikurse edhe parashihet me dispozitat e nenit 73 të KPK-së, kështu që në rastin konkret rrethanat lehtësuese të konstatuara dhe vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, çka edhe pikërisht si rezultat i rrethanave në fjalë të akuzuarit i është shqiptuar dënimi si në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar.

Prandaj, duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana, rrethanat e cekura me aktgjykimin e ankimuar, rrethanat e rastit konkret, pastaj, natyrën dhe llojin e veprës penale, rezulton se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, po ashtu, dënimi është edhe në funksion të preventivës gjeneralë dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPK.

Nga sa u tha më lartë, e konformë dispozitës së nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.294/2017, më 18.08.2017**

Procesmbajtës,  
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

1. Xhevdet Abazi

2. Abdullah Ahmeti

Kryetare e kolegjit,  
Hava Haliti